



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 195

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
DENONCIMIN NR. 43 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË  
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** **Z. Mariglen Disha**  
Kryetar i Bashkisë Librazhd

**OBJEKT:** Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara konkretisht promovimi i veprimtarive publike me karakter social nga ana e Bashkisë Librazhd

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator,

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 43 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtrohet sa vijon:

*“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Bashkia Librazhd ka shpërndarë ndihma ushqimore në ambientet e një shkolle publike. Për sa më sipër kemi dyshime së Bashkia Librazhd ka shkelur Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr.9/2020 të Komisionit Rregulltar si dhe legjislacionin e arsimit duke përdor asete publike për qëllime politike që lidhen me zgjedhjet për Kuvend të datë 11 Maj 2025”.*

Data 25.02.2025

Nr: 195  
Ora: 12:00



“Për mos fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 43 ID, datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

### **V E N D O S:**

1. Mos fillimin e procedurës administrative të denoncimit nr. 43, datë 21.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**